



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT FIER/VLORË/GJIROKASTËR

Nr. 1848 Prot.

Fier, më: 20.06.2022

Lënda: Njoftim për konsultimin me publikun në Subjektin: “DELVINA GAS COMPANY”

BASHKISË DELVINË

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 247, datë 30.04.2014, “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”, Kreu II:

Ju njoftojmë se subjekti “DELVINA GAS COMPANY” NIPT L61416039U më datë 27.06.2022 do të organizojë “Konsultimin me Publikun”, në kuadër të procedurave për marrjen e Lejes Mjedisore Tipi A për aktivitetin: “Kryerjen e operacioneve hidrokarbure dhe gazit natyror në Shqipëri në përputhje me marrëveshjet hidrokarbure. Kërkimi, përpunimi, shitja, shkëmbimi, eksporti, nxjerrja dhe posedimi i naftës së papërpunuar dhe gazit të prodhuar në zonën e projektit në marrëveshjet hidrokarbure, etj. Ndërtimi dhe montimi i të gjitha mjeteve dhe pajisjeve të kërkuara në operacionet hidrokarbure dhe të gazit natyror.”.

Takimi do të zhvillohet më datë 27.06.2022 në orën 12:00, në adresën: Bashkina Delvinë, pranë zyrave të subjektit, (pusi D-14)

Bazuar në VKM Nr. 247, datë 30.04.2014, Kreu II, pika 4.4, shkronja d), Njësia e Qeverisjes Vendore merr pjesë në ditën e zhvillimit të dëgjësës publike si edhe në kuadër të bashkëpunimit institucional dhe në zbatim të Vendimit Nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore”.

Raportin e përmbledhjes jo teknike si dhe informacon rreth subjektit do t'i gjeni në adresat: akm.gov.al, [http://akm.gov.al/publiku në vendimarrje](http://akm.gov.al/publiku_në_vendimarrje) ose drmfier@akm.gov.al.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj!

DREJTOR RAJONAL
Bent VOGLI

